

NENI 1 FORMA LIGJORE, KRIJIMI, SELIA

1. Federata Shqiptare e Boksit dhe qe ne vazhdim do ti referohemi si **FSHBo** është person juridik, e krijuar ne formen e shoqates anëtarët e sëlilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportiv edhe klubet sportive që kanë një status ligjor dhe që ushtrojnë veprimtarinë sporti ne boksit.
2. **FSHBo** eshte e organizuar dhe funksionon ne zbatim te Kodit Civile Republikes se Shqiperise dhe kuadrit ligjore per organizatat jofitimprurese, vepron në bazë dhene zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë, ne per puthje te ligjit Nr.79/2017, datë 27.04.2017, “Për Sportin”, ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, Kodi Civil i R.SH. i ndryshuar, ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, si dhe akte te tjera ligjore dhe nenligjore qe rregullojne keto aktivitete dhe qe jane në fuqinë Republikën e Shqipërisë.
3. Federata Shqiptare e Boksit është anëtare e **AIBA** (INTERNATIONAL BOXING ASSOCIATION AMATEUR) SHOQATA INTERNACIONALE E BOKSIT AMATOR, dhe e **EUBC**(EUROPIAN BOXING CONFEDERATION) KONFEDERATA E BOKSIT EUROPIAN dhe si e tillë ajo i zbaton të gjitha rregullat,direktivat dhe vendimet e tyre dhe kërkon respektimin dhe zbatimin e tyre edhe nga të gjithë anëtarët e saj.
4. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e FSHBo.-së do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të FSHBo-së dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së.
5. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
6. Federata Shqiptare e Boksit eshte i vetmi autoritet pergjegjes qe merret me organizimin, promovimin dhe zhvillimin e sportit te boksit ne Shqiperi.
7. Federata Shqiptare e Boksit eshte e themeluar me nje afat kohore te papercaktuar.
8. Selia e FSHBo-së është në Tiranë, Rr. Liman Kaba – Parku OLIMPIK Feti Borova

NENI 2 STEMA, FLAMURI DHE VULA

1. Federata Shqiptare e Boksit ka Stemen e saj. Forma eshte rrethore me mbishkrimin “Federata Shqiptare E Boksit”. Ne mes te saj eshte e vendosur nje doreze boksi ku ne qafen e saj jane te gdhendura inicialet FSHBo.



2. Flamuri i FSHBo ka formen e nje trekendeshi dybrinjishem ku ne njeren ane ka Flamurin Kombetare dhe ne anen tjeter eshte nje sfond i kuq me stemen e federates.
3. Vula eshte rrethore me stemen e FSHBo.

NENI 3 QELLIMI DHE FUNKSIONET

1. Federata Shqiptare e Bokdsit është person juridik. Ajo e zhvillon veprimtarinë e saj dhe ka si qellim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin dhe perhapjen e sportit te Boksit ne territorine Republikes se Shqiperise duke zbatuar këtë statut, legjislacionin shqiptar, si dhe statutin dhe rregulloret eAIBA-s.
2. FSHBo ka këto objektiva dhe detyra kryesore:

- a) *Te organizoje aktivitete ne Boksit amator dhe profesionist.*
- b) *Të organizojë Kampionatin Kombëtar si detyrim qe buron nga Ligji per Sportin, Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë "Ekipin Kampion Kombëtar" dhe "Ekipin fitues të Kupës së Shqipërisë" në sportin e boksit per femra dhe per meshkuj. Te organizoje Kampionatet Kombetare te Boksit te te gjitha grup moshave dhe gjinive dhe te shpalle ekipet kampion te tyre.*
- c) *Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në federatat dhe organizmat ndërkombëtare të Boksit amator dhe profesionist.*
- d) *Te aderoje duke qene anetare me te drejta te plota sipas udhezimeve te AIBA dhe EUBC ne te gjitha Federatat dhe organizmat e tjera te sportit te boksit qofshin keto amatore ose profesioniste.*
- e) *Te aderoje ne Komitetin Olimpik Kombetare.*
- f) *Të organizojë dhe drejtojë ekipet kombëtare si dhe të marrë pjesën e veprimtarisë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari.*
- g) *Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive ndërkombëtare te te gjitha kategorive te Boksit amator dhe profesionist dhe të japë leje për organizimin dhe mbarevajtjen e tyre me miratimin paraprak te ministrit pergjegjes per sportin.*
- h) *Të marrë masa për parandalimin dhe të luftojë dhunën, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën.*
- i) *Të përdorë simbolet e federatës ose të autorizojë përdorimin e tyre nga anëtarë të tjerë sipas rregullores se brendshme te FSHBo.*
- j) *Të licencojë Trajner për sportine Boksit amtor dhe profesionist ne perputhje me rregulloret e AIBA dhe EUBC dhe te organizmave te tjera.*
- k) *Të drejtoj edhe te kujdeset per mbarvajtjen e te gjithë Gjyqtareve dhe Trainereve te Boksit Kombetare dhe Ndertkombetare qe nderojne ne FSHBo , te jete pjese aktive e shoqatave te ndryshme te tyre si dhe te kontribojeme kurse,seminare,afetisime etj brenda dhe jash tetrriorit te Republikes se Shqiperise per licensimin e tyre.*
- l) *Te ndihmoje ne rritjen dhe zhvillimin e maredhenieve profesionale midis anetareve te FSHBo se, si dhe te mbroje te drejtat e anetareve te saj.*



- m) *Te kujdeset per zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, duke u mbeshtetur ne statut, Rregulloret e saj, Legjislacionin ne Fuqi, si dhe aktet ligjore nderkombetare te veprimtarise ne sportin e boksit.*
- n) *Te marre masa per ndalimin e diskriminimit ne veprimtarite sportive per shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendia ekonomike ose shoqerore.*
- o) *Te perdore eksperiencen e saj per te ndihmuar rritjen dhe zhvillimin e mardhenieve miqesore midis anetareve te FSHBo-se duke inkurajuar frymen e tolerances, te mirekuptimit dhe lojes se drejte (Fair Play) ne te gjitha nivelet e ndeshjeve.*
3. Asnjë person juridik, privat ose publik nuk mund të ushtroje asnje nga kompetencat ekskluzive të FSHBo-së, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarit prej saj.

NENI 4

ANETARESIA

1. Anëtarë të Federatës Shqiptare të Boksit duhet të jenë persona juridik, shoqatat sportive, shoqerit e sportive të krijuar në një nga format ligjore të parashikuara në ligjin "Per sportin", klubet sportive të cilat kanë si objektiv në punën e tyre zhvillimin dhe promovimin e sportit të boksit. Anëtarë të FSHBo-së të cilët kërkojnë të aderojnë pranë saj duhet të njohin dhe zbatojnë statutin dhe rregullore të funksionimit të FSHBo-së.

NENI 5

E DREJTA E FITIMIT TE ANETARESISE

1. Shoqatat, shoqerite dhe klubet sportive mund të kërkojnë anëtarësimin në FSHBo vetëm mbasi të jenë regjistruar në regjistrin e gjykatës përkatëse kompetente, në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Anëtarët për të fituar të drejtën e anëtarësisë duhet të regjistrohen në regjistrin e anëtarësisë, që mbahet në administratën e FSHBo-së.
3. Regjistrimin e Federatës, nuk mund ti refuzohet një kandidati të krijuar në formën e kërkuar nga ligji dhe të miratuar nga asambleja. Një anëtar mund ti refuzohet regjistrimi vetëm kur kërkuesi është krijuar dhe/ose vepron në pa pajtueshmëri me këtë statut dhe me legjislacionin në fuqi.
4. Regjistrimi i anëtarëve bëhet pranë zyrave të FSHBo-së, tek Sekretari i Përgjithshëm, i cili e paraqet atë në Kryesinë Ekzekutive. KE i jep kërkuarit për antaresim të drejtën e të qenit anetare provizor i FSHBo-së dhe me pas shqyrtohet dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e radhës.



5. Asambleja e Përgjithshme, si organi më i lartë vendimarrës në FSHBo, të miratohet si Anëtarë Nderi në FSHBo figura të shquara të boksit, ish sportiste, ish trajnerë, ish gjyqtarë si dhe donatorë të ndryshëm.
6. Selia e anëtarit të Federatës Shqiptare të Boksit duhet të jetë në territorin e Shqipërisë.

NENI 6 TE DREJTAT E ANETAREVE

1. Anëtar i Federatës Shqiptare të Boksit ka këto të drejta:

- a) Të pajiset me kartën e anëtarësisë.
- b) Të pajiset me statutin dhe rregulloren të ndryshme të FSHBo
- c) Të thirret dhe marrë pjesë, me të drejtë vote, në mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të FSHBo-së.
- d) Të informohet rregullisht për rreprimtarinë dhe vendime të Kryesise Ekzekutive të FSHBo-së.
- e) Të njihet dhe të kërkojë informacion në lidhje me administrimin e fondeve të FSHBo-së.
- f) Të kërkojë që të marrë përsipër organizimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe të marrë pjesë në aktivitetet e tjera të ndryshme që organizon FSHBo.
- g) Të zgjidhet në organet drejtuese të FSHBo-së, në përputhje të plotë me nenet e kësaj statuti.

2. Anëtari provizor ka të drejtë të përfitojë të drejtat e parashikuara në germa a), b), d), të kësaj Neni.

NENI 7 DETYRIMET E ANETAREVE

1. Të jetë korrekt ndaj FSHBo-së duke zbatuar me korrektësi këtë statut, rregulloren të saj edhe mos të ndermarre veprime kundër interesave të FSHBo-së.
2. Anëtarët e regjistruar në FSHBo janë të detyruar të kontribuojnë për FSHBo nëpërmjet pagimit të kuotizimeve, ku vlera e tyre si dhe koha e pagesës janë të përcaktuara nga Asambleja e përgjithshme në rregulloren e brendshme.
3. Të zgjedhë organet e saj drejtuese ekzekutive.



4. Te njoftojë menjëherë FSHBo per çdo ndryshim në statutin dhe rregullore te veta sipas të gjitha procedurave ligjore.
5. Çdo aktivitet i organizuar (nga anëtari) duhet që, në pjesën qëndrore të saj të ketë të vendosur logon e FSHBo-së dhe të sponsorëve të saj.
6. Te njohe parimet e ndersmerise, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
7. Të marrin pjesë në mbledhje te Asamblesë së Përgjithshme të FSHBo-së.

NENI 8

PEZULLIMI I ANETARIT

1. Shkelja këtij statuti, rregulloreve, direktivave, si dhe vendimeve të FSHBo-së, i jep të drejtën Kryesise Ekzekutive dhe Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë me vendim te arsyetuar te organit kompetent çdo anëtar të saj nga anëtarësimin e FSHBo për një periudhë, e cila parashikohet nga rregulloret perkatese, ose vendoset nga KE.
2. Çdo vendim pezullimi, përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit, për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.

NENI 9

HUMBJA E STATUSIT TE ANETARIT

1. Anëtari humbet anëtarësinë në këtë Federatë kur jep dorëheqjen ose kur përjashtohet.
2. Përjashtimi i një anëtari nga FSHBo-ja bëhet në rast të, mos pagimit të kuotizacionit të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe/ose për mosrespektim të këtij statuti, rregulloreve të FSHBo-së dhe ligjeve në fuqi, te mbështetura me vendim te arsyetuar te organit kompetent.
3. Humbja e cilësisë së anëtarit, nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërmbushura kundrejt FSHBo- së ose anëtarëve të tjerë. Me përjashtimin e tij, anëtari humbet të gjitha të drejtat që lidhen me FSHBo-në.

NENI 10

DORËHEQIA E ANETARIT

Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje, me kusht që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit buxhetor. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më parë. Në kete rast nuk i vijojne detyrimet e reja financiare te FSHBo, pervec atyre qe nuk jane permbushur deri ne ate moment.



NENI 11
ORGANET DREJTUESE TE FEDERATES SHQIPTARE TE BOKSIT

1. Organet e FSHBo-së janë:

- a) *Asambleja e Përgjithshme*
- b) *Presidenti*
- c) *Kryesia Ekzekutive*
- d) *Sekretari i Përgjithshëm*
- e) *Komisionet:*
 - *Komisioni disiplinës*
 - *Komosioni apelit*
 - *Komosioni teknik/arbiter/trainer*
 - *Komisioni financa*

NENI 12
ASAMBLEJA E PËRGJITESHME

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendim marrës i Federatës Shqiptare të Boksit dhe përfaqëson autoritetin më të lartë të sajë. Vetëm një asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme, përbëhet nga teresia e të gjithë anëtarëve të saj, të cilët përfaqësohen me 1 (një) votë.
3. Në asamblenë e përgjithshme jozgjedhore, marrin pjesë pa të drejtë vote anëtarët e KE-së, Sekretari i Përgjithshëm, të ftuar të tjerë, staf teknik i Federatës si dhe ata që kanë marrë nga FSHBo mandatin e vëzhguesit për atë asamble.
4. Pjesëmarrësit në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë vote mund të diskutojnë vetëm në rastin kur drejtuesi i Asamblesë ju jep fjalën.
5. Kryesia Ekzekutive vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
6. Presidenti ka të drejtë që të ftojë në Asamblenë e Përgjithshme drejtues të Federatës Ndërkombëtare të Boksit, ose figuratëshquar të boksit shqiptarë, evropian dhe botëror.
7. Asambleja thirret nga Presidenti, 2/3 e KE ose 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote. Njoftimi për mbledhjen bëhet nga sekretari i përgjithshëm i FSHBo-së me letër-rekomandë, fax ose e-mail.
8. Asambleja drejtohet nga Presidenti, ose në mungesë të tij nga anëtar më i moshuar i KE, ose nga një person i zgjedhur me konsensus.



9. Proces-verbali i mbledhjes nënshkruhet nga Presidenti dhe sekretari i përgjithshëm, por kur shikohet e arsyeshme firmoset edhe nga anëtarët e Asamblese.

NENI 13

PERFAQESIMI DHE EMERIMI NE ASAMBLE I DELEGATEVE

1. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHBo-së, nëpërmjet organizmave të tyre vendimmarrëse zgjedhin përfaqësuesit e tyre në asamblenë e FSHBo-së, të cilët regjistrohen në FSHBo.
2. Çdo përfaqësues i regjistruar ka të drejtën e një anetari me një votë në Asamble.
3. Anëtarët e FSHBo-së duhet të regjistrojnë në FSHBo përfaqësuesit e tyre jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë së përgjithshme të FSHBo-së. Mandati apo autorizimi i tyre për të qenë delegat në AP nuk duhet të jetë më i vjetër se 10 ditë përpara datës së regjistrimit në FSHBo.
4. Delegatët me të drejtë vote paraqiten në asamble duke paraqitur dokumentin zyrtar të identifikimit.
5. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtar apo përfaqësuesi të një anëtari tjetër.
6. Përfaqësuesit e regjistruar me të drejtë vote, nuk mund të përfaqësohen nga persona të tjerë në asamble.
7. Anëtarët e nderit, vëzhguesit ose të ftuarit nuk kanë të drejtë vote.
8. Votimi me prokurë nuk lejohet.

NENI 14

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

1. Asambleja e Përgjithshme e FSHBo-së ka këto kompetenca:



a) Miratim ndryshime të statutit të FSHBo-së në përputhje me ligjin për sportin.



- b) Shqyrton çështjet financiare si dhe miraton buxhetin vjetore të Federatës. Përcakton programet e veprimtarisë së FSHBo-së.
 - c) Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e programeve të miratuara.
 - d) Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga Kryesia Ekzekutive.
 - e) Shqyrton çështjet administrative të FSHBo-së.
 - f) Zgjedh Presidentin e Federatës me votim të fshehtë.
 - g) Zgjedh anëtarët e Kryesise Ekzekutive me votim të fshehtë.
 - h) Miraton ose refuzon anëtarësimin, pezullimin, dorëheqjen dhe humbjen e statusit të anëtarëve të FSHBo-së.
 - i) Miraton vetshpërndarjen e federatës dhe likuidimin financiar të saj.
 - j) Asambleja miraton kompaninë audituese të pavarur që ka eksperiencën dhe kualifikimin e nevojshëm për auditimin e llogarive financiare, sipas procedurave dhe percaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Asambleja e përgjithshme miraton rregulloren e disiplinës, kodin e etikës, rregulloren për organizimin e zgjedhjeve dhe votimit, rregulloria e funksionimit të KE dhe rregulloren të tjera të nevojshme për ecurinë dhe realizimin e qëllimit të FSHBo-së.

NENI 15

MBLEDHJET E ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

1. Asambleja mbledhet në mbledhje të Zakonshme jo më pak se një herë në vit, në mbledhje të Jashtëzakonshme sa here që shikohet e domosdoshme dhe në Asamble Zgjedhore një herë në kator vjet.
2. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmësë anëtarëve.
3. Vendimet në Asamblesë së Përgjithshme do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
4. Në mbledhjet e Asamblesë mund të ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, anëtarët e Kryesise Ekzekutive, Sekretari i Përgjithshëm i FSHBo-së, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për sportin apo të Komitetit Olimpik Shqiptar, personalitete të Boksit Kombëtar, Nderkombëtar, biznesmene dhe të tjere personalitete të ftuar nga KE. Të ftuarit mund të diskutojnë pas lejes së dhënë nga Presidenti i Asamblesë.
5. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshohet, shfuqizohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
6. Asnjë anëtar i Asamblesë së Përgjithshme nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai është në kushtet e konfliktit të interesit.
7. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rëndin e ditës.



8. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Presidenti i ndihmuar nga dy anëtarë të Kryesise Ekzekutive dhe në mungesë të tij mbledhjen e Asamblesë e drejton zëvendës Presidenti i ndihmuar nga anëtarët e Kryesise Ekzekutive. Kur mungon dhe Z.Presidenti atëherë mbledhja drejtohet nga anëtari me i vjetër i Kryesise Ekzekutive, duke u emëruar Kryetar dite.

NENI 16

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ZAKONSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme, thirret nga Presidenti ose Kryesia Ekzekutive te pakten një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve deri në 15 ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
2. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme shqyrton dhe vendos për aktivitetin sportiv e financiar të vitit paraardhës, aktivitetin sportiv dhe financiar të edicionit në vazhdim, pranimin ose përjashtimin e anëtarëve të FSHBo-së, si dhe çdo çështje tjetër e kërkuar sipas rregullave të këtij statuti, nga anëtarët e FSHBo-së.
3. Rendi i ditës përcaktohet nga Kryesia Ekzekutive. Dokumentat shoqëruese për t'u shqyrtuar sipas rendit të ditës, i dërgohen anëtarëve jomëvonëse 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
4. Rendi i ditës mund të ndryshojë kur atë e kërkon 2/3 e anëtarëve me të drejtë vote, por vetëm në fillim të mbledhjes, para fillimit të punimeve të Asamblese.
5. Proces verbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhet nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm. Në qoftë se shikohet e arsyeshme firmoset nga të gjithë delegatët votues.
6. Procedurat dhe afatet e zhvillimit të Mbledhjeve të Asambleve janë të njëjta, përveç rasteve kur në mënyrë unanime KE vendos ndryshe.

NENI 17

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E JASHTEZAKONSHME

1. Asambleja e Jashtëzakonshme mbledhet sa herë që kjo shihet e domosdoshme.
2. Asambleja e Jashtëzakonshme thirret nga Presidenti, Kryesia Ekzekutive, si dhe me kërkesën e të paktën 1/3 e anëtarëve të FSHBo-së. KE është i detyruar të thërrasë një Asamble të Jashtëzakonshme, jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës së bërë nga 1/3 e anëtarëve. Nëse asambleja nuk thirret, atëherë anëtarët që e kërkuan atë, mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune.



3. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e thirrur nga 1/3 e delegatëve mbledhet në këto raste:

a) Kur ka abuzime të rënda financiare ,të konfirmuara nga auditi i Ministrisë përkatëse për sportin e Boksit ,ose audituese privatë të licensuar.

b) Kur ka shkelje të rënda të legjislacionit në fuqi. (ligji sportit ,i OJF-ve,statutit dhe rregulloreve të FSHBo-së)

4. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
5. Dokumentat shoqëruese për çështjet që do të shqyrtohen sipas rendit të ditës, i dërgohen anëtarëve të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
6. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështje të caktuar. Kjo kërkesë duhet të paraqitet te Sekretari i Përgjithshëm FSHBo-së, tëpaktën 15 ditë përpara ditës së mbledhjes.
7. Asambleja e Jashtëzakonshme shqyrton dhe vendos përndryshimet e Statutit, emërimin dhe shkarkimin e Presidentit, emërimin dhe shkarkimin e Kryesise Ekzekutive, shkrirjen e FSHBo-së si dhe çështje të tjera që kërkohen nga anëtarët për t'u shqyrtuar dhe që nuk janë në kompetencë të Asamblesë së Zakonshme.
8. Në rastin e doreheqjes së Presidentit ,Kryesia cakton zëvendës Presidentin të kryejë funksionin e Presidentit në mënyrë të përkoshme deri në thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme. Në këto raste Asamblenë e Përgjithshme e mbledh Kryesia Ekzekutive. Mandati i Presidentit te Ri eshte vetem per periudhen e mbetur kohore nga Presidenti paraardhes, pervec rastit kur me shume se 2/3 e KE vendosin ndryshe qe zgjedhjet te jene edhe per President edhe per Anetare te KE per nje mandat te Ri kater vjecare. Procedura e zgjedhjes se Presidentit te ri si dhe e Anetareve Per KE eshte e njejte me ate te zgjedhjeve sipas Nenit 19 ketu me poshte.
9. Proces verbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nënshkruet nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm. Ne qofte se shikohet e arsyeshme firmoset nga të gjithë delegatët votues.

NENI 18

MARRJA E VENDIMEVE NGA ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

1. Asambleja është e vlefshme kur anëtarët e saj janë thirrur regullisht dhe kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një asamble tjetër e përgjithshme duhet të mbledhet jo më përpara se 24 orë dhe jo mëvonëse 72 orë pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë përveç rasteve kur, në rendin e ditës janë parashikuar ndryshime në statutin e FSHBo-së, emërimi ose shkarkimi i presidentit dhe komitetit drejtues, pranimi ose



përfashtimi i një anëtari të FSHBo-së ose shkrirja e FSHBo-së, për të cilat kërkohet një shumicë prej 2/3 e votave të anëtarëve të FSHB-së.

3. Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës, përveç rastit kur të gjithë anëtarët janë të pranishëm.
4. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e përfaqësuesve e kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e presidentit është përcaktuese.
5. Vendime të marra nga asambleja hyjnë në fuqi menjëherë, me përjashtim të rasteve kur vendime të saj bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi. Vendimet e saj i njoftohen brenda 10 ditësh titullarit përgjegjës përsportin.

NENI 19 ZGJEDHJET NE FSHBo

1. Zgjedhjet në FSHBo janë periodike në cdo katër vite.
2. Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore zgjedh Presidentin dhe Kryesinë Ekzekutive me votim të fshehtë
3. Të drejtën për të kandiduar për postin e Presidentit dhe për Anetare të KE e ka cdo anëtar i Asamblesë së Përgjithshme, si dhe cdo person tjetër që është në përputhje të plotë me Nenin 20, pika 1, germa a, b, c, d, e, f. dhe Neni 22, pika 2, germa a, b, c, d, e, f, g.
4. Çdo kandidat si për President ashtu edhe për anetare të KE të FSHBo ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij.
5. Jo më pak se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve, FSHBo nepermjet Kryesisë së saj Ekzekutive njofton anëtarët e saj për datën e zgjedhjeve me sqarime të qarta për materialet zgjedhore, propozimet e kandidaturave të tyre si dhe vendin ku do mbahen zgjedhjet. Mënyra e organizimit të zgjedhjeve, procedura e ndjekur, njoftimet, afatet, përcaktohen në rregulloren e organizimit të zgjedhjeve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
6. Anëtarësia e FSHBo duhet që jo më pak se 15 ditë përpara datës së zgjedhjeve të njoftojë FSHBo për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, propozimet e kandidaturave që ata kanë për President dhe anetare të KE të FSHBo. Njekohesisht FSHBo nga anëtarësia do të vihet në dispozicion cdo e dhënë tjetër që do të kërkohej në njoftimin sipas pikës 5 të këtij Neni.
7. FSHBo verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet KE për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet përfaqësuesve të anëtarëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari, Këshilli drejtues duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut.



8. Një anëtar i FSHBo-së nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për President apo anëtar në KE.
9. Anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme që propozojnë kandidatin për President ose Anëtar i KE nuk duhet të jenë të pezulluar.
10. Në raundin e parë, Presidenti ka nevojë për 2/3 e votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin këtë shumicë, bëhet një raund i dytë zgjedhesh midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr më shumë vota zgjidhet President. Në rastet e votave të barabarta, votimi do të përsëritet. Nëqoftëse edhe votimi i dytë përfundon me rezultat të barabartë, vendimi merret nëpërmjet hedhjes së shortit nga Komisioni i numërimit.
11. Kandidatë për anëtarë të Kryesise Ekzekutive, zgjidhen nga lista e personave që janë propozuar për anëtarë të këtij Këshillit, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave të të gjithë anëtarëve.
12. Proces verbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të nënshkruet nga të gjithë delegatët votues. Materialet zgjedhore vërtetohen me noter të pranishëm në mbledhje, konforme legjislacionit shqiptarë në fuqi. Noterja e pranishme së bashku me Sekretariatit e Federatës përgatisin dosjen zgjedhore, për ta dërguar në gjykatën e rrethit Tiranë, për të regjistruar aktet zgjedhore në pranimin e OJF-ve.

NENI 20 PRESIDENTI

1. Presidenti i FSHB-së zgjidhet me votim të fshehte nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve të FSHBo-së.

Kandidati për president duhet të:

- a) jetë shtetas shqiptar, mebanim në Shqipëri.
- b) ketë arsim të lartë.
- c) ketë figurë të pastër morale.
- d) Mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe/ose të huaja.
- e) mos të ketë konflikt interesi me postin e presidentit.
- f) ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit të boksit.
- g) Të jetë propozuar nga një anëtar i federatës (klub, Shoqatë apo shoqëri sportive, ose 1/4 (Një e Katërta) e Anëtarëve të Asamblesë, të cilët nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për President të FSHBo.



h) Te mos jete ne konflikt interesi ne te qenit ne postin e Presidentit.

2. Presidenti zgjidhet për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje sa herë që asambleja e vlerëson kandidat të vlefshëm.
3. Presidenti i FSHBo është njëherazi President i Asamblese së Përgjithshme dhe Kryetare i Kryesise Ekzekutive.

NENI 21 KOMPETENCAT E PRESIDENTIT

1. KompetencatePresidentitjanësimëposhtë:


- a) Të përfaqësojë FSHBo-në si i vetmi përfaqësues i saj ligjor.
- b) Të kërkojë thirrjen e A.P dhe të thërrasë mbledhje të K.E-së.
- c) Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e K.E-së.
- d) Të sigurojë zbatimin e vendimeve të asamblesë dhe të K.E-së.
- e) Në rast se presidenti mungon, ose vendi i tij mbetet bosh, detyrat i ngarkohen një personi tjetër të zgjedhur me votim të fshehtë nga KE deri në asamblenë e radhës.
- f) Në mbledhjen më të afërt të Asamblesë së Përgjithshme zgjidhet presidenti i ri për kohën e mbetur deri në përfundim të mandatit.
- g) Me propozim të Kryesise Ekzekutive dhe paskonsultimeveqëaiimendontënevojshme, tëzgjedhëdheemërojëtrajnerëteekipitKombëtar.
- h) Mbas konsultimeve me KE të punesoje prane FSHBo specialiste të ndryshme për nevojat e saja duke nënshkruar kontrate me ta me afat 1 vjeçar dhe me të drejtë ripërteritje.
- i) Të akordojë dhe të japë tituj e cmime në persona që kanë kontribut për FSHBo.

NENI 22 KRYESIA EKZEKUTIVE

1. Kryesia Ekzekutive është organi më i lartë ekzekutiv i FSHBo dhe zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përbëhet nga një numër prej 5 anëtarësh, duke përfshirë edhe Presidentin e FSHB-së.

2. Anëtarët e KE-se duhet të:

- a) *Jenë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri, të kenë mundësi të kontributit në sportin e Boksit, biznesmënë, pjesë e personelit të FSHBo, personalitete në fusha të ndryshme etj.*
- b) *Kenë arsim të lartë.*
- c) *Kenë figurë të pastër morale.*
- d) *Mos jenë të dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj.*
- e) *Mos jenë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi, apo anëtar i një organi gjykuar të FSHBo-së.*
- f) *Mos jenë njëkohësisht anëtarë të një federate tjetër. (anëtar komisioni, kolegji etj).*



- g) Mos jenë të dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
- h) Të jenë propozuar nga një anëtar i federatës (klub, Shoqate apo shoqeri sportive, ose 1/4 (Nje e Katerta) e Anetareve te Asamblese, te cilet nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për anëtar në KE.
- i) Mos kenë konflikt interesash me të qenit anëtar i K.E-së.

3. Anëtarët e Kryesise Ekzekutive zgjidhen për një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtarët e KE mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KE, Asambleja e përgjithshme duhet të zgjedhë anëtarin pasardhës për të ushtruar funksionet për kohën e mbetur/me mandat të ri.
6. Vendimet në Kryesine Ekzekutive merren me shumicë votash të anëtarëve.
7. Këshilli drejtues mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Asamblesë së Përgjithshme për marrje të vendimit.

NENI 23

KOMPETENCAT E KRYESISE EKZEKUTIVE

1. Kryesia Ekzekutive ka këto kompetenca:

- a) Të marrë vendime që ndihmojnë në punët e FSHBo-së.
- b) Emeron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Presidentit.
- c) Zgjedhe dhe cakton Zevendes Presidentin brenda rradheve të saj.
- d) Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive.
- e) Të angazhohen realisht në drejtimin e komisioneve që funksionojnë në FSHBo.
- f) Të hartojë projekt buxhetin dhe t'ia paraqesë asamblesë për miratim
- g) Të mbikqyr dhe kontrollojë zbatimin e vendimeve të marra nga asambleja dhe vetë ato në veprimtarinë e administratës së FSHBo-së.
- h) Të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e komisioneve.
- i) Të pezullojë e të përjashtojë (jo për gjithmone) anetare të FSHBo sa here që ajo e shikon të arsyeshme se është shkelur statuti dhe rregullorja dhe janë cenuar interes të FSHBo.
- j) Të përcaktojë, organizojë dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.
- k) Të mbajë lidhje me organizata sportive kombëtare dhe ndërkombëtare dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FSHBo-së për t'u zgjedhur në to.



- l) Kryesia Ekzekutive harton rregulloren e funksionimit të administratës së FSHBo-së, përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm, përcaktimet mbi funksionimin e arkiv protokollit, rekrutimin e punonjësve, administrimin e vules.
- Kjo rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithëshme.

NENI 24

MBLEDHJET E KRYESISE EKZEKUTIVE

1. Kryesia Ekzekutive mbledhet jomë pak se kater herë në vit, por sa herë ajo e shikon të nevojshme.
2. Mbledhjet e saj e drejtohen nga presidenti dhe në mungesë të tij nga anetari me i vjeter I KE.
3. Mbledhjet e KE-se thirren nga presidenti, sekretari i përgjithshëm ose nga shumica e anëtarëve të KE-se. Njoftimi për mbledhje i dërgohet anëtarëve jo më vonëse 7 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. (me përjashtim të e mergjencave)
4. Në mbledhje të KE-se mund të marrin pjesë edhe specialistë të ndryshëm të ftuar për të dhënë mendime për çështje të rendit të ditës.
5. Për mbledhjet e KE-së mbahet proces-verbal, i cili firmoset nga presidenti, sekretari i përgjithshëm dhe anëtarët e KE.
6. Mbledhjet dhe vendimet e Kryesise Ekzekutive janë të vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rastin e votave të barabarta, presidenti ka votë vendimtare.
7. Anëtarët e Kryesise Ekzekutive duhet që të marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Kur një anëtar mungon në mbledhje tre herë rradhazi pa arsye të forta, duke mos permbushur kështu detyrimet e tija ai përjashtohet. Akti i përjashtimit shoqërohet me vendim të argumentuar. Me pas ai zëvendësohet nga kandidati i rradhës që ka fituar më shumë vota në garën zgjedhore.

NENI 25

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

1. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FSHBo-së. Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti me propozim të Kryesise Ekzekutive. Ai mund të jete një prej anëtarëve të Kryesise Ekzekutive ose edhe jashtë saj. Kur zgjidhet nga KE-ja jep doreheqjen prej saj dhe vendin e tij në KE e zë kandidati me numër më të madh votash dhe që nuk ka arritur prapë në KE-së.



2. FSHBo i bën kërkesë ministrise përgjegjëse për sportin, për kryerjen e procedurave të ndryshimit të firmës së nepunësit autorizues i cili do të kryejë detyrën sipas Statutit të FSHB-së.
3. Sekretari i Përgjithshëmduhet:
 - a) Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri.
 - b) Të ketë arsim të lartë. (preferohen shkencat juridike, ekonomike)
 - c) Të ketë figurë të pastër morale.
 - d) Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja.
 - e) Të mos jetë një kohësisht trainer, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të FSHBo-së.
 - f) Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegjiumi etj).
 - g) Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
 - h) Të mos ketë konflikt interesash me të qenit sekretar i përgjithshëm.
4. Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm janë:
 - a) Të zbatojë vendimet e asamblesë dhe të KE-se.
 - b) Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e KE e të organeve të tjera të FSHBo-së.
 - c) Të organizojë dhe drejtojë gjithë veprimtarinë e përditshme administrative e financiare të FSHBo-së.
5. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbarrëvajtjen dhe funksionimin e administratës së FSHBo-së, si dhe për drejtimin e personelit të punësuar në FSHBo.
6. Sekretari i Përgjithshëm raporton përpara Kryesise Ekzekutive dhe Presidentit sa herë i kërkohet një gjë e tillë.

NENI 26

VITI DHE BURIMET FINANCIARE

1. Viti financiar është viti kalendarik që fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.
2. Burimet financiare të Federatës Shqiptare të Boksit sigurohen nga:
 - a) Fondet shtetërore të akorduara në formë granti të parashikuara në buxhetin e shtetit dhe të miratuara nga ministria përgjegjëse për sportin.
 - b) Kuotat vjetore të anëtarësimit të anëtarëve të FSHBo-së, (të caktuara nga asambleja) të cilat kryhen sipas rregullore vetë brendshme që e rregullojnë këtë marrëdhënie.



- c) *Të ardhura te krijuara nga marketing I të drejtave televizive dhe reklamave për aktivitet nderkombëtar e të ekipeve kombëtare që gëzon Federata Shqiptare e Boksit.*
 - d) *Sponsorizimet, dhurimet, financimet nga shteti në formën e investimeve dhe projekteve, si dhe burime të tjera të lejuara me ligj.*
 - e) *Nga licensimi i trajnerëve, sportistëve, mjekëve, vëzhguesve, specialistëve, amatorëve.*
3. Klubet sportive dhe sportistët e Boksit, në përputhje edhe me rregulloret e FSHBo-së, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit, FSHBo-së ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës përkatëse sportive dhe me aktet ligjore në fuqi.
4. Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

NENI 27 SPORTISTI

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre dhe rregulloret e përcaktuara nga FSHBo-ja.
2. Pjesëmarrja e sportistit në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.
3. Transferimi i sportistit të Boksit nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive të miratuara nga FSHBo-ja dhe nga AIBA& EUBC.

NENI 28 KATEGORITE E SPORTISTEVE NE BOKS

1. Sportistët në sportin e boksit ndahen në Amatore, Amatoro- Profesione (anetare të AIBA& EUBC) dhe Profesione (anetare të Federatave respektive Nderkombetare), në përputhje me statutet, udhëzimet e Federatave respektive Nderkombetare.
2. Sportistë Amatorë të Boksit janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e Boksit dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën sportive ku janë regjistruar.



3. Sportistët Amatoro-Profesionistë të Boksit anetare të AIBA & EUBC janë ata sportiste që praktikojnë sportin e Boksit si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.
4. Sportistët Profesionistë të Boksit, anetare të Federatave të tjera Nderkombëtare (përveç AIBA & EUBC), janë ata persona që praktikojnë sportin e Boksit si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive, në të cilat ata janë anëtarë.

NENI 29

STATUSI I SPORTISTIT TE NIVELIT TE LARTE

Sportistët e Boksit të cilët përfitojnë statusin e nivelit të lartë në përputhje me Ligjin për Sportin, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: “rekord olimpike”, “rekord botëror”, “rekord evropian”, “vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike”, “vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate botërore” dhe “vendi i parë deri në të tretin në kampionate evropiane” dhe “vendi i parë në Lojërat Mesdhetare”. Në veprimtari kombëtare zyrtare: “vendi i parë në kampionatin kombëtar”.

NENI 30

TRAINERI

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive anëtare të FSHBo-së duhet të punësojnë trajnerë të licencuar nga FSHBo-ja dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe FSHBo-ja, kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtejshëm të trajnerëve në bashkëpunim me institucione përkatëse të fushës.

NENI 31

DETYRIMET E SPORTISTIT DHE TRAINERIT

1. Sportisti i Boksit duhet të respektojë rregullat e FSHBo-së dhe të AIBA e EUBC, parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë së boksit.



2. Trajnerët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e FSHBo-së.

NENI 32

NDERTIMI DHE PERDORIMI I OBJEKTEVE SPORTIVE

1. Objektet sportive ndërtohen dhe përdoren sipas rregullave teknike, higjeno-shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Standardet, kontrolli, mbikqyrja e objekteve sportive parashikohen në rregulloren mbi ndërtimin dhe përdorimin e këtyre objekteve.

NENI 33

DREJTESIA SPORTIVE

1. FSHBo-ja krijon organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Organet e gjykimit disiplinor të FSHBo-së shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesë-marrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së FSHBo-së.
3. Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të FSHBo-së, mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 15-ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

NENI 34

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

1. FSHBo-ja pranon autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.
2. Vendimet e organeve drejtuese të FSHBo-së që bien në kundërshtim me ligjin dhe me këtë Statut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit të mundjes, ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS), organ i ngritur pranë Komitetit Olimpik Shqiptar. Të gjitha organizatat sportive të mundjes dhe çdo sportist apo trajner me titull individual në sportin e Boksit, kanë të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjet.



3. Vendimet e paneleve të arbitrave/ndërmjetësve ankimohen pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 30-ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) shqyrton ankimin brenda 30-ditëve dhe merr vendim.
4. FSHBo-ja, klubet dhe shoqatat sportive, shoqëritë dhe çdo sportist apo trajner me titull individual në sportin e Boksit, pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS). FSHBo-ja njeh dhe zbaton vendimet që merr këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) për vete dhe për anëtarët e saj.
5. Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (KAS), në Lozanë të Zvicrës.
6. Mosmarrëveshjet midis anëtarëve të FSHBVo-së për Asamblene e Përgjithshme Zgjedhore palët do të zgjidhin në gjykatën e shkallës së parë të rrethit Tiranë.

NENI 35

PERDORIMI I SUBSTANCAVE ANTI-DOPING

1. FSHBo-ja pranonë autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre, dhe dënimin e përdoruesve të dopingut
2. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive të sportit të Boksit është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.
3. Lista e substancave dhe metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
4. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga FSHM-ja.
5. FSHBo-ja njeh dhe merr përsipër të zbatojë sanksionet mbi Anti-dopingun dhe Feminitetin, konform rregullores së AIBA dhe EUBC në këtë fushë.
6. FSHBo-ja njeh autoritetin e Organizatës Kombëtar Antidoping në ushtrimin e kontrolleve antidoping me sportistët anëtarë të FSHBo-së.
7. FSHBo-ja dhe të gjithë organizatat sportive anëtare të saj, pranojnë masat disiplinore dhe dënimet e dhëna nga Organizata Kombëtare Antidoping dhe nga AIBA për sportistët anëtarë të FSHBo-së që rezultojnë pozitiv në këto kontrolle.
8. FSHBo-ja dhe Organizata Kombëtare Antidoping, si dhe të gjitha organizatat sportive të Boksit anëtare të FSHBo-së, janë të detyruara të respektojnë antidopingun sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006. Për aderimin e Republikës së



Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005”, dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989”.

NENI 36

KONTROLLI MJEKESORE NE SPORT DHE SIGURIMI SHENDETESORE I SPORTISTEVE

1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në FSHBo dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj, pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e Boksit të anëtarësuar në FSHBo pajisen me kartelë mjekësore vetjake.
2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licensuar, të paktën një herë në 6-muaj, për matjen e parametrave jetësorë.
3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare të Boksit bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.
4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.
5. Organizatat sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHBo-së, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive të boksit.
6. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t’u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
7. Organizata sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHBo-së, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive e sportistëve të Boksit të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.



8. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.
9. Organizatat sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHBo-së, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive të mundjes.
10. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
11. Organizata sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHBo-së, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive e sportistëve të Boksit të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
12. FSHBo është përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare.

NENI 37

PARANDALIMI I DHUNES NE SPORT DHE RUAJTJA E RENDIT

1. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve
2. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:
 - a) sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve.
 - b) gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve.
 - c) shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor.
 - d) ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike.
 - e) dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv.




- f) sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qoFShin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve.
- g) gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve.
- h) shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor.
- i) ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike.
- j) dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv.
- k) veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë.
- l) hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv.
- m) hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik.
- n) djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv.
- o) përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës.
- p) trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.

3. Organizatori i veprimtarisë sportive të Boksit është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.
4. FSHBo, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport ku aderon Republika e Shqipërisë.
5. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive të Boksit dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.
6. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit, personat në cilësinë e përfaqësuesit të FSHBo-së, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.
7. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.
8. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:

- a) sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qoFShin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;



- b) *gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;*
 - c) *shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;*
 - d) *ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;*
 - e) *dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;*
 - f) *veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;*
 - g) *hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;*
 - h) *hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;*
 - i) *djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;*
 - j) *përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;*
 - k) *trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.*
9. Organizatori i veprimtarisë sportive të Boksit është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.
10. FSHBo, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport ku aderonte Republika e Shqipërisë.
11. Ndalohe mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjedisit sportive të Boksit dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.
12. Gjatë veprimtarive sportive të Boksit, personat në cilësinë e përfaqësuesit të FSHBo-së, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.
13. Organizatori i një veprimtarie sportive në Boks është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim të paktën 7-ditë kalendarike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj.
14. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive realizohet nga organet apo instucionet sipas kuadrit ligjor në fuqi.
15. Administratorët e mjediseve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësive policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.
16. Në veprimtaritë ndërkombëtare të Boksit brenda dhe jashtë vendit, FSHBo-ja merr masa për sigurinë e ekipeve kombëtare nëpërmjet kontaktimit të organeve kompetente të sigurisë.



NENI 38
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut ose për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.97/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, Kodit Civil, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” të ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” të ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të FSHBo-së, përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente, miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për Sportet.




NENI 38
HYRJA NE FUQI

Miratur nga Asambleja e Pergjitheshme, Vendim Nr. 2, dt. 22/03/2018

Perfaqesuar nga Presidenti i FSHBo Florend Kalivopulli

Florend Kalivopulli



Miratur me Urdher te Ministrit te MASR

Vendimit te Gjykates se rrethit Gjyqesor, Tirane

